

VENDIM
Nr. 421, datë 4.7.2012

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË
TERRORIZMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 5 të ligjit nr. 9258, datë 15.7.2004 “Për masat kundër financimit të terrorizmit”, me propozimin e Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur sipas rezolutave të Këshillit të Sigurimit (lista e OKB-së), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet, si më poshtë vijon:

1. Në fund të shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët”, shtohen personat e renditur në listën “a” “Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për talebanët.

2. Në fund të shkronjës “C” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, shtohen personat e renditur në listën “c” “Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida”, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida-n, sipas shtesave në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për Al-Qaida-n.

3. Nga lista e shkronjës “A” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët”, çregjistrohen personat e renditur në listën “b” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

4. Nga lista e shkronjës “C” “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida” çregjistrohen personat e renditur në listën “d” “Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida””, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si persona të çregjistruar nga anëtarë ose bashkëpunëtorë me Al-Qaida-n me rezolutë të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

a) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët:

1. SANGEEN: ZADRAN;
2. FAIZULLAH: NOORZAI; AKHTAR MOHAMMED: MIRA KHAN;
3. MALIK: NOORZAI;
4. ABDUL AZIZ: ABBASIN;
5. AHMAD: ZIA: AGHA;
6. FAZL: RABI;
7. MOHAMMAD: AMAN: AKHUND;
8. AHMED JAN: WAZIR;
9. ABDUL SAMAD: ACHEKZAI;

b) Lista e të çregjistruarve nga “Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me talebanët”:

1. QALAMUDIN: SARANDAZ;
2. RAHMATULLAH: WAHIDYAR: FAQIR: MOHAMMAD;
3. HABIBULLAH: FAWZI;
4. ARSALAN: RAHMANI: MOHAMMAD: DAULAT;
5. SAYEEDUR RAHMAN: HAQANI;
6. MOHAMMAD: RABBANI: RAFIULLAH: MUAZEN;
7. MOHAMMAD SEDIQ: AKHUNDZADA;
8. RAHIMULLAH: ZURMATI;
9. ABDUL GHAFOOR;
10. MOHAMMAD SOHAIL: SHAHEEN;
11. SHAMSULLAH: KMALZADA;
12. SAYED: ALLAMUDDIN;
13. MOHAMMAD: HUSAYN: MUSTAS'ID;
14. MOHAMMAD: DAUD;
15. NOOR: JALAL: GUL JAN;

c) Lista e shtuar e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida:

1. SON: HADI: BIN MUHADJIR;

d) Lista e të çregjistruarve nga "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida":

1. MONDHER: BEN MOHSEN: BEN ALI: AL-BAAZAOUI;
2. SA'D: ABDULLAH: HUSSEIN: AL-SHARIF;
3. MOUNIR: BEN HABIB: BEN AL-TAHER: JARRAYA;
4. FETHI: BEN AL-RABEI: BEN ABSHA: MNASRI;
5. KAMAL: BEN MOHAMED: BEN AHMED: DARRAJI;
6. IBRAHIM: ABDUL SALAM: MOHAMED: BOYASSEER;